

## **AKT THEMELIMI**

### **I SHOQËRISË “3ET STUDIO” SH.P.K**

Z. **Endri Skrapari**, shtetas shqiptar, i biri i Maliqit, lindur më 05.01.1981 ne Elbasan, banues në Tiranë, mbajtës i Letërnjoftimit me ID me Nr. I10105052T, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me Ligjin 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar) dhe Ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar “3ET Studio” Sh.p.k, (më poshtë referuar si “Shoqëria”),

#### **NENI 1**

##### **EMËRTIMI**

Emri i Shoqërisë është “3ET Studio” Sh.p.k

#### **NENI 2**

##### **SELIA**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në Adresën: Zona Kadastrale Nr.8370,Volumi 20, Faqe 162, me adrese rruga “Rr. 4 deshmoret”,Tiranë, Shqipëri.

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

#### **NENI 3**

##### **KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

## **NENI 4**

### **OBJEKTI**

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

Konsulence inxhinierike, projektme, studime, supervision, kolaudim etj te infrastructures dhe objekteve te ndryshme civile dhe industriale. Shoqëria do të kryejë pa kufizim çdo aktivitet tjetër të lejueshëm nga legjislacioni në fuqi edhe pse jo i përmendur në këtë akt.

## **NENI 5**

### **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 1000 Lekë dhe është i ndarë në kuota.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z. Endri Skrapari**, zoteron 1 kuotë, me 100 % të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 1000 Lekë dhe të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të mara me shumicat e parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

## **NENI 6**

### **ORGANET E SHOQËRISË**

Organet e Shoqërisë përbëhen nga Asambleja e Ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm, **Z. Endri Skrapari**.

## **NENI 7**

### **LEGJISLACIONI I APLIKUESHEM**

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

## **NENI 8**

### **DISPOZITA FINALE**

Ky Akt Themelim hartohet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Përmbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortakët themelues të shoqërisë duke autorizuar **Z. Endri Skrapari**, mbajtës i Kartës së Identitetit me nr. I10105052T, për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

### **ORTAKËT THEMELUES**

**Z. Endri Skrapari**



**Tiranë më, 15.06.2020**